



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13.12.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHCH	7432/2023		1/7



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**A.nr.1288/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1288/2023, të datës 16.10.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër 3955 të datës 29.09.2023 të Ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në çështjen juridike „*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.12.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.1288/2023, e datës 16.10.2023, e parashtruar nga ankuesi ashtu që aprovohet pretendimi lidhur me kontestimin e kompetencës se organit që ka nxjerrë vendimin e kundërshtuar me ankesë, ndërsa, refuzohet pretendimi ankimor lidhur me kthimin e ankuesit në pozitën e punës sipas Akti të Emërimit të datës 18.04.2013.
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër 3955, i datës 29.09.2023, i Ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- III. Obligohet** Qeveria e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- IV. Obligohet** Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ankuesit ti bëjë kompensimin e pagës në pozitën e Zëvendëskryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nga data e Vendimit me numër 3955, të datës 29.09.2023 deri në zbatimin e këtij vendimi.

- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje referuar ankuesi), më datë 16.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1288/2023, kundër Vendimit 3955, të datës 29.09.2023, të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për lirim të ankuesit, nga detyra e Zëvendeskryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi gjegjësisht me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publikë, Rregullores Nr.03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Rregullores Nr.01/2011 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse, me vendimin e atakuar ka pasur aplikim të gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale. Shton se, organi që ka nxjerr vendimin e atakuar nuk është kompetent duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, 1.5 pika 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publikë. Kërkon që Këshilli të anuloi vendimin e kundërshtuar më ankesë dhe të obligoj Ministrin e MBPZHR që ta kthej ankuesin në pozitën sipas Akti të Emërimit me numër të protokollit 1776 të datës 18.04.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 7133/2023, të datës 29.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1288/2023, të datës 16.10.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 16.10.2023 me numër protokollit 6549/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 3955 të datës 29.09.2023 të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Akt emërimit e ankuesit me Nr.1776 të datës 18.04.2013; Akt emërimit e ankuesit me Nr.764 të datës 29.02.2012; Vendimin me Nr.131/2020 të datës 10.08.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin me numër A.nr.795/2021 të datës 30.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 24.10.2023 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; Kërkesën e datës 04.01.2012 me numër 037 lidhur me miratimin dhe autorizimin

për fillimin e rekrutimit për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në AUV; Formularin për vlerësimin e punës provuese të ankuesit të datës 03.01.2013; Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës së ankuesit të datës 31.12.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2014; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit të datës 31.12.2015; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit të datës 30.12.2016 si dhe Vendimin me numër protokolli 7133/2023 të datës 29.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave material ka gjetur së ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër 1776 të datës 18.04.2013, është emëruar në pozitën ZëvendësKryeshefit Ekzekutiv, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me mandat të përhershëm. Tutje, nga shkresat e lëndës rrjedhë së me Vendimin nr.131/2020 të datës 10.08.2020, Kryeministri i Kosovës ka autorizuar ankuesin që të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (nga këtu AUV), deri në marrjen e një vendimi tjetër, kurse me Vendimin Nr.Ref.127/2021, të datës 27.08.2021, Kryeministri i Kosovës ka shfuqizuar Vendimin Nr.131/2020, të datës 10.08.2020, për shkak të ndryshimit të rrethanave ligjore përkatësisht se pozita e ankuesit si Zëvendëskryeshef Ekzekutiv i AUV-it nuk është e përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Pas Vendimit Nr.Ref.127/2021 të datës 27.08.2021, ankuesi ka vazhduar të ushtroj pozitën e Zëvendëskryeshefit Ekzekutiv të AUV-it, kurse me Vendimin me numër 3955, të datës 29.09.2023 të Ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ankuesi është liruar nga detyra e Zëvendës Kryeshefitekzekutiv të AUV-it, duke filluar nga data 26.09.2023, me arsyetimin së lirimi i ankuesit behët mbi bazën e Vendimit ref.127/2021 të datës 27.08.2021 të Kryeministrit të Kosovës, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të bëjë sistemimin e ankuesit në ndonjë vend të lirë të punës në kuadër të AUV-it.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton së ankesa A.nr.1288/2023 është e pranueshme, mbi bazën se ankuesi ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë, ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli është kompetent për trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me paragrafin 2 i cili parasheh: "2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.....", dhe Ligjin Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku parasheh:"1.1.Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe*

*parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil “.*

Nga analizimi i aktit të goditur me ankesë rezulton se nuk është kontestuese procedura apo mënyra e themelimit të marrëdhënies se punës e ankuesit, por fakti së pozita e ankuesit më titull Zëvendëskryeshef Ekzekutiv i AUV-it nuk është e përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-114 për Zyrtarët Publikë, në fuqi nga data 10.07.2020 dhe i zbatueshëm deri me 25.09.2023, andaj, edhe mbi këtë bazë Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me vendim kontestues ka liruar ankuesin nga pozita e Zëvendëskryeshefit Ekzekutiv të AUV-it, duke kërkuar edhe sistemimin e tij në kuadër të AVU-it pa përcaktim të kategorisë dhe klasës së pozitës.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje administrative, ka analizuar:

- Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me datë 09.07.2020), me theks të veçantë nenin 23 ku përcaktohej se: “1. Personeli i punësuar në Shërbimin Civil ndahet në katër (4) kategori funksionale: 1.1. nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues; 1.2. nëpunës civilë të nivelit drejtues; 1.3. nëpunës civilë të nivelit profesional; 1.4. nëpunës civilë të nivelit tekniko – administrativ”, ndërlidhur me këtë, me nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcaktohej se: “Vendet e punës në institucionet e nivelit qendror dhe lokal në Shërbimin Civil ndahen në katër kategori funksionale: 1.1. Niveli i Lartë Drejtues, është pozitë përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm administrativ të institucionit të administratës publike në shërbimin civil. 1.2. Niveli Drejtues, është pozitë përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e punës në fushë të caktuar të veprimtarisë së institucionit të administratës publike në shërbimin civil...”,
- Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 10.07.2020 deri me 26.09.2023), përkatësisht dispozitat e nenit 33 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. **Kategoria e lartë drejtuese**, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. **Kategoria e mesme drejtuese**, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. **Kategoria e ulët drejtuese**, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. **Kategoria profesionale**, që përfshin zyrtarët profesionalë” ndërlidhur me këtë me nenin 4 paragrafi 1.1, nenin 5 dhe nenit 10 të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: “4. Në pajtim me ligjin për zyrtarët publik, pozitat e punës në shërbimin civil dhe institucionet e administratës së shërbimit publik ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. **kategoria e lartë drejtuese**; 5.1. **Kategoria e lartë drejtuese** është kategoria më e lartë e menaxhimit të një institucioni që ka përgjegjësinë për hartimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre. Pozitat e kësaj kategorie janë përgjegjës për të: 1.1. përcaktuar objektivat dhe hartuar programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatim; 1.2. siguruar përdorimin efikas të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave; 1.3. planifikuar dhe drejtuar veprimtarinë e përditshme administrative të institucionit; 1.4. përfaqësuar atë në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit. 10. **Klasat përbërëse të kategorisë së Lartë Drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Lartë 3 Zëvendësdrejtor Ekzekutive në një Agjenci të Pavarur, Rregullatore dhe Ekzekutive ”.**

- Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht nenin 12 ku përcaktohet se: *Agjencia Ekzekutive themelohet për të kryer funksionet administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie apo Zyrës së Kryeministrit, si në vijim: 1.1. zbatimin e ligjit, duke zgjidhur çështje individuale dhe duke kryer veprime administrative sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative; 1.2. mbledhjen e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore, kontributeve apo detyrimeve të tjera dhe menaxhimin e tyre për qëllimin për të cilin janë krijuar; 1.3. mbrojtjen e sigurisë publike nëpërmjet ushtrimit të autorizimeve policore, dhënien e lejeve, licencave, autorizimeve dhe miratimeve për veprimtari ekonomike specifike dhe kryerjen e inspektimeve; 1.4. mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit për Qeverinë; 1.5. ushtrimin e përbashkët të funksioneve të brendshme mbështetëse. 2. Agjencia Ekzekutive themelohet me ligj”, kurse, me nenin 22 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm. 4. Në rastet e agjencive të mëdha dhe me veprimtari komplekse, në ligjin e themelimit të agjencisë mund të përcaktohet që drejtori ekzekutiv të mbështetet nga jo më shumë se (2) dy zëvendës drejtorë. Zëvendës drejtori është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe Rregulloren Nr.03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përkatësisht :

- Nenin 2 më të cilin është përcaktuar: *Fushëveprimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë Fushëveprimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejme Agjencia) është përcaktuar me legjislacionin i cili e rregullon çështjen e sigurisë së ushqimit, me prejdardhje shtazore dhe bimore, çështjen e shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe të mirëqenies së tyre, shëndetin e bimëve, çështjen e kontrollit zyrtar veterinar, fitosanitar dhe sanitar, si dhe me legjislacionin tjetër përkatës.*
- Neni 3, i cili përcakton se : *Organizimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë 1. Agjencia është Agjenci Ekzekutive, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. 2. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv. 3. Për kryerjen efikase të përgjegjësisë, autorizimeve dhe detyrave të punës që i janë caktuar, Agjencia organizohet në drejtori dhe zyra regjionale: (Shtojca 1- Organogrami i Agjencisë): 4.Në Agjenci varësisht nga kërkesat zhvillimore dhe organizative për kryerjen e detyrimeve dhe kompetencave ligjore, me propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë dhe me miratimin e Kryeministrit mund të formohen edhe njësi të reja organizative. 5.Drejtoritë, zyrat regjionale dhe njësitë tjera përkatëse do t'i kenë përgjegjësitë dhe funksionet e tyre, siç parashihet me legjislacionin në fuqi për fushëveprimin e Agjencisë dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës e cila nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv në afat prej më së largu gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje”*
- Neni 4, ku parashihet se: *1. Kryeshefi Ekzekutiv drejton veprimtarinë e Agjencisë e përfaqëson atë dhe vepron në emër të saj. Ai është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë dhe kryen detyra të tjera, brenda kompetencave që ka, në zbatim të ligjit e të akteve nënligjore në fuqi. 2.Zëvendëskryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë zëvendëson Kryeshefin në mungesë të tij dhe kryen punët dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas fushave përkatëse të*

*caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv. 3. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe zv. Kryeshefit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat relevante në fuqi në Republikën e Kosovës.*

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër dhe në mbështetje të shtojcës 1, numër rendor 35, të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Kolegji konstaton së Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është e përcaktuar si agjenci ekzekutive dhe së Kryeshefi Ekzekutiv, mund të mbështet dhe nga dy (2) Zëvendëskryeshefa Ekzekutiv. Rrjedhimisht, pozita e Zëvendëskryeshefit Ekzekutiv të AUV-it ka qenë e përcaktuar me Rregulloren Nr.03/2012 për Organizimin Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, e miratuar nga Qeveria e Republikës e Kosovës me datë 17.09.2010 ( ende në fuqi) dhe se ankuesi bazuar në Aktin e Emërimit të datës 18.04.2013 është kategorizuar në pozitën e nivelit drejtues, pa afat të caktuar. Ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, pozita e ankuesit në kuptim të dispozitave të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, neni 5 dhe neni 10, është kategorizuar si pozitë e nivelit të lartë drejtues, me afat të caktuar katër vjeçar.

Andaj, nisur nga fakti me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, kemi ndryshim të rrethanave ligjore përkatësisht së pozita e ankuesit përcaktohet si pozitë e nivelit të lartë drejtues me afat të caktuar, Kolegji konstaton se njësi përgjegjëse për emërimin dhe lirin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues për institucionet e administratës shtetërore është Qeveria përkatësisht ministria përkatëse për administratë publike siç është përcaktuar me nenin 40 dhe nenin 61 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, kështu që mbi këtë bazë të konstatimit rezulton së vendimi i kontestuar më ankesë është nxjerrë nga organi jo kompetent dhe se pretendimi ankimor mbi këtë fakt është i bazuar.

Për më tepër, siç u përcaktua me lartë se në raport me pozitat e nivelit të lartë drejtues, si njësi kompetente është Qeveria/Ministria përkatëse për Administratë Publikë, tani Ministria e Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit thekson faktin, së kjo e fundit, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë, ka qenë e detyruar të bëjë rregullimin e statusit të pozitave të cilat kanë pësuar rregullim ligjor, qoftë në kuptim të statusit, kategorisë apo afatshmerisë, siç është rasti me pozitën e ankuesit, si dhe të bëjë sistemin e tyre, duke aplikuar në analogji dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe neni 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publikë.

Referuar rrethanave dhe konstatimet si më sipër, kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e ankuesit, të shfuqizohet Vendimi me numër 3955, i datës 29.09.2023, i Ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe të obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat si në dispozitiv të këtij vendimi, të bëjë sistemimin e ankuesit në pajtim me dispozita përkatëse në fuqi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1288/2023*

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;*
- *Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;*
- *Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*